



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Njesia Org. Org. Jedinica Org. Unit	5
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	3428
Data: Datum Date	26.09.2023
- Prishtinë / -	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 26-09-2023
Nr. 5/3428

Komisioni për licencimin e BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 5 me protokoll 3248 të datës 15.09.2023 të parashtruar nga BPrAL - kolegji "BIZNESI" për plotësim-ndryshim të vendimit nr. 5/1048, i datës 31.08.2021 dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi nr. 5/1048 i datës 31.08.2021, me të cilin është licencuar Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - kolegji "BIZNESI", me qendër në Prishtinë dhe degën në Prizren, për periudhën trevjeçare 30.09.2021 deri me 30.09.2024.
2. Pika 1 e vendimit nr. 5/1048 i datës 31.08.2021, mbetet e pandryshuar.
3. Vendimit të shënuar më lartë i shtohet edhe teksti si në vijim :
Licencohet BPrAL – kolegji "BIZNESI" sipas vendimit nr.3039/21 datë 12.08.2021 për programet e akredituara nga AKA : Qendra në Prishtinë, 1). Menaxhment dhe Ekonomikst – BA; 2). Menaxhimi i Emergjencave – BA; 3). Juridik LLB; 4). Menaxhment dhe Financa - MA; 5). Menaxhimi i Emergjencave – MA.
Qendra në Prizren; 1).Banka dhe Financa në Biznes – BA.
4. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pandryshuar.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr.5 me nr.protokolli 3248 të datës 15.09.2023, të parashtruar nga kolegji

“BIZNESI”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Plotësim – ndryshimi i këtij vendimi vjen si arsyetim i institucionit - kolegjit “ BIZNESI” dhe i njëjti arsyetim është marrë për bazë nga ana e Komisionit për Licencim duke e miratuar atë. Në vendimin nr. 5/1048 të datës 31.08.2021, nuk janë përfshirë programet sipas pikës 3 të këtij vendimi pasi që Agjencioni i Kosovës për Akreditim, paraprakisht e ka njoftuar institucionin në fjalë se e ka fituar të drejtën e akreditimit për ato programe. Prandaj për ta respektuar afatin kohor për aplikim për Licencim në MASHTI Kolegji parashtron kërkesë për licencim pa i pasur vendimet e akreditimit. Vendimet e Agjencionit për Akreditim kolegji i ka marrë para se të Licencohet, por që nuk janë bashkangjit me kohë shtesë kërkesës së parashtruar. Dëshmitë janë ofruar të plota nga ana e Kolegjit.

Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë, zgjat tri vite akademike (30.09.2021 deri me 1 tetor 2024) sipas vendimit nr. 3039/21 datë 12.08.2021 të Agjencionit të Kosovës për Akreditim.

Komisioni për licencim i MASHTI, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit


Burim Gashi